



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 02 mars 2020, në mbledhjen e XXIX (njëzet e nëntë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (35 - Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive, (DA; DBF; DKA; DPKGJ; DSHMSH; DPZHE), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke konstatuar kuorumin, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të rendit të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur, ndër të tjera shtoi, para se të fillojmë me rendin e ditës dëshiroj t'ju njoftoj që një anëtare dhe një anëtarë të Kuvendit të Komunës (Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri) kanë dhënë dorëheqje pasi të njëjtit janë zgjedhë Deputet/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë si Kryesues i Kuvendit kam zhvilluar të gjitha procedurat për zëvendësimin e tyre dhe tani Komisioni Qendrorë Zgjedhor – KQZ ka marrë vendimet përkatëse me të cilët ka emëruar anëtarët e rinj të Kuvendit, përkatësisht znj.Floretë Zejnullahu është zëvendësuar nga znj.Mimoza Stublla Abdullahu, dhe z.Fitim Haziri është zëvendësuar nga z.Pajtim Balaj, prandaj pa humbur kohë ftoj komisionin për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit (Avni Fetahu, Doruntina Hasani, Fatmir Rudari) të bëjë verifikimin e mandatit të dy anëtarëve dhe në fund të dalin me një raporte të shkurtër. Anëtari i parë i këtij komisioni sigurisht që duhet të zëvendësohet nga subjekti i LDK-së për arsye tash më të ditura dhe pres që të deklarohet edhe këtu para Kuvendit, por tani besoj se mund të vazhdojmë kështu me këtë përbërje.

- **Dhënia e betimit nga anëtarët e ri të Kuvendit të Komunës së Podujevës;**

z.Avni Fetahu, paraqiti raportin e Komisionit, theksoi, bazuar në Vendimet e KQZ-së dhe Rregulloreve në fuqi që janë zëvendësimi i të përmendurve është në rregull dhe ne vetëm i'u dëshirojmë sukses z.Pajtim Balaj dhe znj.Mimoza Stublla Abdullahu.

Kryesues i Kuvendit, falënderoj komisionin përkatës, theksoi, konsideroj se tani jemi në rregull dhe mund të bëhet betimi solemn nga të përmendurit, anëtari i ri dhe anëtarja e re, të Kuvendit të Komunës së Podujevës

Para se të fillohet me dhënien e betimit ju sqaroj se betimi solemn bëhet si në vijim, fillimisht ngrihemi në këmbë, unë dhe dy anëtarët e ri, unë lexoj deklaratën e betimit kurse Ju të dy vetëm e përsëritni me zë atë që unë e lexoj, me të vetmin ndryshim që pas fjalës Unë, ju përmendni emrat e juaj.

Me tekstin si në vijim;

Unë.....(duke cekur secili emrin e vet), betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

U konstatua se z.Pajtim Balaj dhe znj.Mimoza Stublla Abdullahu, nga tani e tutje janë këshilltar/e të mandatit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që iu takojnë.

Duke i'u dëshiruar suksese dhe punë të mbarë dy anëtarëve të ri të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit vazhdoi me punë sipas rendit të propozuar të ditës.

z.Avni Fetahu, theksoi, unë Avni Fetahu nga sot do të jem pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje, duke falënderuar subjektin LDK që deri më tani kam qenë, për korrektësinë dhe kontributin e dhënë të përbashkët në të mirë të qytetarëve, nga sot jam pjesë e LVV-së, vendim të cilin e kam marrë vetëdijshëm si rezultat i pakënaqësisë të përgjithshme qytetare, jo vetëm për interesin personal.

Në asnjë formë nuk do të toleroj që vendimi im për të dalë në subjektin politik LVV të përdoret si interes personal për të marrë pozita, për arsye se jeni dëshmitar ju si Kryesues i Kuvendit dhe disa shokë tjerë që mua më janë afruar pozita e pushtet mirëpo në politikë nuk kam hyrë të marrë pushtet por të jem i dinjitetshëm para qytetarëve. Në të njëjtën kohë subjektin LVV e kam dëshmitar që asnjë pozitë nuk e kemi diskutuar me ata, por jemi hyrë me të vetmin qëllim, për ndryshimin e mirë të qytetarëve. Jam i vetëdijshëm që këtë diskutim timin këto ditë e kam zhvilluar të paktën me 900 vetë përmes rrjeteve sociale dhe jeni të bindur që 90% të tyre më janë falënderuar për këtë vendim timin dhe vetëm 10% të tyre më kanë kritikuar, dhe atë fort bile, që nuk kam dalë më herët në LVV. Përndryshe unë në politikë kam hyrë dinjitetshëm, mbajeni mend këtë fjalë, sa të jem gjallë dhe shëndetshëm në politikë kam hyrë dinjitetshëm dhe dinjitetshëm do të dal.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe shëndet parafolësit, theksoi, shpresoj të mos jesh vonuar me këtë kalim. Vazhdojmë me punë, rendi i propozuar së bashku me materialin përkatës dhe konstatimet e rekomanduara nga KPF ju janë shpërndarë me kohë dhe të gjithë e posedoni,

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 31 janar 2020.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po ndërlidhem me këtë pikë, gjegjësisht Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, dhe në këtë kam një çështje, më 21 shkurt 2020 Nënkryetari i Komunës dhe tani edhe kandidat për Kryetar të Komunës, ka dalë me deklaratë në TV Klan, se lidhur me taksën bizneseve në qendër të qytetit ku edhe po bëhen punime, ka dal që vendimin e ka marrë Grupi i

asamblistëve të LDK-së, e që unë mendoj se është vendim i drejtë, padyshim që të vlerësohet sado pak aktiviteti i bizneseve në qendër të qytetit, por megjithatë është i paligjshëm sepse ne të gjithë kemi qenë prezent në sallë dhe jemi në dijeni që vendim për heqjen e taksës së cekur nuk kemi pasë, dhe është përgjegjësi e organit përfaqësues që jemi ne për marrjen e vendimeve të tilla, kështu që vendimi është i paligjshëm për faktin që nuk ka kaluar në asamble, prandaj unë mendoj që një gafë apo gabim i tillë i shkeljes së ligjit, e që ndoshta e ka si praktik ta shkel ligjin por megjithatë unë mendoj që Kryesuesi i Kuvendit duhet të bisedoj me të në mënyrë që të mos e përdorë asambleen komunale dhe të deklarohet për vendimet të cilat nuk janë marrë nga asambleja komunale. Pra jeni në dijeni se në mbledhjen e kaluar, në pikën të ndryshme këshilltari z.Qëndrim Softolli vetëm ka dhënë propozim për heqjen asaj takse, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 31 janar 2020.

2. Informatë për punët dhe aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, gjatë vitit 2019

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, e paraqiti, në cilësinë e Koordinatorit të KKSB-së në Komunën e Podujevës e paraqiti Informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, sipas planit të punës, ju është paraqitur kjo informatë rreth aktiviteteve të KKSB-së gjatë viti 2019. Është konstatuar se janë mbajtur të gjitha mbledhjet sa janë obligative, dhe si grup punues jemi munduar që t'ju sjellim një informatë sa më të rëndësishme në mënyrë që të keni të gjitha informacionet e punës së këtij Këshilli. Sigurisht që vlerësimi mund të jetë i ndryshëm nga ju por ne tani nuk mund të ndryshojmë asgjë sepse bëhet fjalë për diçka që ka qenë në vitin e kaluar, janë punë që janë diskutuar, janë shqyrtuar, kemi dalë me konstatime, janë marrë vendime dhe çështje dhe aktivitete tjera të ndërmarra nga KKSB duke përfshirë edhe vërejtjet e ndryshme të dhëna gjatë vitit 2019, por qëllimi i kësaj është që Ju si Kuvend të jeni sa më të informuar rreth punës dhe aktiviteteve njëvjeçare të KKSB-së dhe gjendjes në territorin e Komunës së Podujevës, kjo duke u bazuar edhe në raportet e Policisë të bazuar edhe në statistika, pastaj raportet tjera të drejtorive të ndryshme për tema të caktuara por edhe sugjerimet e juaja të dhëna në periudha të ndryshme por edhe ato që tani mund t'i jepni në pikën e radhës në mënyrë që ta përmirësojmë sa më shumë punën dhe çështje e ndryshme të Këshillit.

z.Vendenis Lahu, në emër të Grupit të LVV-së duke uruar mirëseardhje dhe punë të mbarë anëtarëve të rinj të Kuvendit si dhe z.Avni Fetahut për kalimin në LVV, theksoi, mendoj se KKSB është një mekanizëm i rëndësishëm lokal për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së rendit dhe sigurisë në Komunën tonë dhe për shkak të rëndësisë së tij ky këshill udhëhiqet nga Kryetari i Komunës.

Në bazë të raportit të KKSB-së shihet se Kryetari ka munguar në shumë mbledhje, e që ndoshta ai nuk e ka parë të rëndësishëm por pa paragjykuar, arsyet i din më mirë ai vetë.

Unë do t'i jap disa vërejtje dhe sugjerime lidhur me sigurinë në bashkësi, të cilat i konsideroj të nevojshme, dhe atë;

-Fillimisht dëshiroj të potencoj rëndësinë e sigurisë në shkolla, në dokument kemi parë që në raportet e Policisë janë evidentuar tri raste të cilat gjatë kontrollit janë gjetur armë në pronësi të nxënësve, unë jam i bindur se ka më shumë raste të armëmbajtjes pa leje në shkolla, andaj mendoj se është e rëndësishme të shtohet apo të rritet numri i kontrolleve nëpër shkolla sepse armët në ambientet shkollore, për shkak se mbajtja e armëve në ambientet shkollore janë të rrezikshme, sidomos për

nxënësit tjerë të cilët shkojnë në shkollë për të vijuar procesin edukativo arsimor. Po ashtu si pikë të rëndësishme e shoh edhe shitjen e alkoolit dhe duhanit nxënësve në afërsi të shkollave të cilët kuptohet se janë minorent, pra nxënësit e shkollave të mesme, pak ka të atillë që janë mbi moshën 18 vjeçare por sido qoftë është shumë e rëndësishme që të kontrollohen ato vende ku shitet duhani dhe alkooli në afërsi të shkollave.

-Problem tjetër të cilin e shoh si problem janë qentë endacak, këto ditë kemi parë që është raportuar nëpër media se qentë endacak janë futur në Spitalin e qytetit, pikë kjo e cila ndoshta i takon edhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe ndoshta mund të jetë edhe temë tjetër, por ajo çka dua të cekë është se paraqitet rrezik permanent nga qentë endacak. Oborri i spitalit është shndërruar në një ambient jetese e një grumbull të madhe të qenve, ka raste kur këta qenë endacak kanë sulmuar edhe nxënësit e shkollave të cilët kalojnë andej pari për në shkollat “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri”, pra unë vetë kam qenë dëshmitar, prandaj mendoj se është një çështje e cila duhet të trajtohet me prioritet dhe t’i jepet zgjidhje sepse e rrezikon sigurinë e nxënësve por edhe personave të rritur.

-Pikë tjetër të cilën dua ta potencoj është siguria në komunikacion, kemi mungesë të sinjalistikës në rrugët tona, madje jemi të informuar dhe kemi parë rastin tragjikë të para disa muajve ku një mërgimtar i joni i cili ka bërë 1600 – 1700 km rrugë nga Austria dhe ka përfunduar fatalisht në magjistralen Podujevë – Prishtinë, ndoshta magjistralet janë nën menaxhimin e nivelit qendrorë por KKSB mendoj se është një mekanizëm i cili duhet të merret pikërisht me këto raste sepse fundja ai këshill është për të mbrojtur sigurinë dhe jetën e qytetarëve.

-Pikë tjetër e cila mendoj se duhet të trajtohet me prioritet po ashtu është edhe çështja e zjarrfikësve, pajisjet e tyre ka kohë që janë në funksion dhe shumica prej tyre janë të amortizuara e që mendoj se do të ishte mirë ose të krijohej një fond apo ndonjë donacion që do ta përmirësonte gjendjen në objektin e zjarrfikësve dhe pajisjeve të tyre për ndihmë komunitetit sepse me ardhjen e verës besoj se do të rritet edhe numri i rasteve ku do të kërkohet intervenimi i zjarrfikësve.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, a keni menduar për sigurinë e punëtorëve që Qendrën për Punë Sociale ku ata punëtor ndihen të rrezikuar në çdo moment, e që në një vizitë të bërë nga ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, punëtorët e këtij institucioni na kanë thënë që në disa raste kemi edhe kërcënime me armë, atëherë mund të themi se siguria në vendin tonë nuk është e mirë.

Çështja tjetër që është edhe më shqetësuese e që nuk e keni marrë asnjëherë parasysh është siguria e punëtorëve shëndetësorë, duke u nisur nga siguria e njerëzve me çrregullime mentale kur dihet se në disa raste kanë edhe kërcënime nga ata, pastaj siguria në urgjencën e qytetit që shpeshherë ndodhë që janë kërcënuar edhe me armë. Le ta mendojmë rastin e maternitetit ku punëtorët e këtij institucioni kanë adresuar kërkesë tek ne që të ngritët në seancë ku çështja e sigurisë së këtyre punëtorëve, e sidomos e kujdestarive të natës ku në gjithë atë objekt aq të madh dhe shumë pa plan, 12 orë qëndrojnë vetëm dy femra kujdestarë ku në disa raste dhe në mungesë të gjinekologut rastet duhet të dërgohen me autoambulancë në Prishtinë dhe ku shoqërohet nga njëra prej punëtorëve të maternitetit kështu që punëtorja tjetër mbetet vetëm. Pra tek ne duhet të ndodh diçka e keqe për tu ndërmarrë diçka pozitive, të ishin këto punëtorë nëna, gra apo motra tonat besoj se do të ndërmermim diçka e që duhet të ndërmerret.

z. Hasan Ajeti, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, Drejtori i Drejtorisë përkatëse në fjalën hyrëse, përveç informatës në formë të shkruar që na është sjellë, paraqiti edhe një informatë shtesë në pika të shkurtra në formë analitike dhe sintetike rreth punëve dhe aktiviteteve të KKSB-së gjatë vitit 2019, për çka jemi të gjithë këtu dëshmitarë. Temat që më pastaj u ngritën nga kolegët tanë, veçmas nga LVV, janë tema puro politike dhe të pastra pa asnjë dyshim dhe kjo punë tani veç po dihet, madje këta edhe formulimin e kanë politik. E them këtë sepse temat që u përmenden rreth të punësuarve

janë të rregulluara me ligje të veçanta, andaj ju lus ta konsultoni këshilltarin nga radhët tuaja z.Bajram Ajeti i cili mendoj se është njohës i mirë i fushës.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, faktikisht desha të diskutoj për një pikë të cilën këshilltarja kolege znj.Adelinë Stublla e tha që disa mjekë/punëtorë të mjekësisë e kanë njoftuar se kanë qenë të kërcënuar me armë, e që mendoj se me armë nuk mund të kërcënoj askush por kërcënimin me armë nëse bëhet në një vend publik është serioz për institucionin por më shumë për individin që afektohet. Si pyetje e kam, a jeni njoftuar ju Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë apo a është njoftuar ndonjëri nga personeli shëndetësorë që ndonjë prej punëtorëve në vendin e tyre të punës është kërcënuar me armë sepse edhe duhet të njoftohet dikush nga ai i cili është kërcënuar dhe kush ka qenë ai që ka kërcënuar dhe për çka. Pastaj a është njoftuar ndokush prej organeve të rendit siç është Stacioni i Policisë. E them këtë sepse sado që ndokush mund të jetë i painformuar, nëse ndokush ngreh/nxjerrë revolen dhe e kërcënon, e din që së pari duhet të lajmërohet policia e cila pastaj duhet ta luaj rolin e vet, dhe tani nëse ai doktor apo punëtor shëndetësorë e ka lajmëruar një asamblistë se dikush e ka kërcënuar, por nuk e ka njoftuar Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe organet e rendit – Policinë, për mua personalisht mbetet as andej as këndej sepse të ndodh që të kërcënohet me armë dhe mos të jeni në dijeni dhe të njoftuar organet e Policisë, është e pakuptimtë sepse është kërcënim serioz, mirëpo edhe nëse ka ndodh ashtu që ka pas kërcënim të atij personi që ju ka njoftuar juve (i drejtohet Adelinë Stubllës), për mua ai person nuk është serioz në vendin e tij të punës ngase nuk mund të mbrohet privatisht aty ku punon sepse është institucion i cili po thuajse vizitohet nga rreth 5000 qytetarë brenda javës me probleme të ndryshme shëndetësore duke mos përjashtuar edhe ndonjë çrregullimi nervor, por nuk mund ta lëmë të vazhdoj kjo problematikë.

Sa i përket planit të punës, ne edhe në KPF e diskutuam këtë, e që si Kuvend në mënyrë institucionale kemi ftuar çdo Drejtorin dhe çdo akter dhe çdo institucion që është bartës të përgjegjësisë në aspektin e sigurisë, që të bëjnë planin e punës dhe të miratohet ai plan, gjithnjë për interesa të qytetarëve. Sa i përket koncepteve politike mund të them se të gjithë ne si subjekte politike kemi programe politike të ndryshme e që në bazë të tyre shprehim mendimin për secilën fushë që është më së miri të kryhet sipas programit, prandaj meqë jemi në para fushatë zgjedhore nuk guxojmë ti politizojmë pikat e rendit të ditës të cilat janë në interes të qytetarëve, dhe tani do të ishte mirë që këshilltaren znj.Adelina Stublla ta pyesim ngase nuk guxojmë ne të dalim nga kjo mbledhje vetëm ashtu kur dikush “kërcënohet me armë” në vendin e punës, pra është mira ta thërrasim atë doktor dhe ta pyesim se a e ka njoftuar ai Drejtorin z.Zaim Thaqi, kur është kërcënuar me armë, ashtu siç u tha, pastaj Drejtori të thërret Komandantin e Stacionit të Policisë dhe ta pyet se a ka njoftim për kërcënim me armë të personelit të shëndetësor, NN doktorit të QKMF-së apo jo, dhe nëse nuk ka bërë deklaram dhe mund të jetë e vërtetë, me automatizëm dikush duhet të ndërmerr masa ngase askush nuk mund të sillet si “kauboj” me armë dhe të kërcënojnë njerëz nëpër Podujevë, gjë e cila nuk do ta lejohet nga organet e rendit dhe shteti në përgjithësi, prandaj konsideroj se nuk është mirë të dalim nga ky Kuvend me këtë që dikush është kërcënuar me armë në vendin e punës në institucion dhe dikush tjetër nuk ka marrë masa, përndryshe edhe ne këtu do të ndiheshim të pasigurt sepse do të hynte ndokush me armë dhe do të na kërcënohte dhe neve si këshilltarë të Kuvendit.

Kështu që në këtë pikë lus znj.Adelinë Stublla, meqë ajo e ngriti këtë çështje, edhe pse nuk po e dim kush është ai person, pra deri sa jemi duke diskutuar këtë çështje mund të dilni në korridor dhe ta pyetni atë person, a është në dijeni Drejtori z.Zaim Thaqi për kërcënimin që ju është bërë në vendin e punës dhe a keni njoftuar organet e rendit, dhe unë apo ndokush nga ne mund të shkoj tek Komandanti i Policisë dhe ta pyes a jeni në dijeni dhe nëse po a keni marrë masa, mirëpo mos të hymë me hipoteza tani, me logjikën “më tha ky, më tha ai”.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, jemi Institucion më i lartë legjislativ i Komunës, prandaj ju lus prandaj kërkoj nga secili që për çdo pyetje, kërkesë, sqarim etj, mundësisht të jetë i bazuar dhe i argumentuar, e mos të flitet nga ndonjëri vetëm ashtu në mënyrë hipotetike për gjëra të tilla sepse vërtetë mund të dalim jo serioz. Unë nuk jam në dijeni për rastin që u potencua por edhe nëse ka ndodh një gjë e tillë është mirë të sqarohet ngase ekzistojnë masa ligjore të parapara për situata të tilla të mundshme.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, për shkak të konfidencialitetit të punëtorit shëndetësorë unë nuk mund ta jap emrin.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë fare nuk jam i interesuar të replikoj, e sidomos për pika të tilla të ndjeshme. Jam në dijeni se përmendja e ndokujt me emër është konfidenciale, madje që kur jam pjesë e këtij Kuvendi unë kam hapur tema të ngjashme dhe kam thënë, unë nuk dua të përmendi emra, por nëse dëshiron ndokush natyrisht se ia tregoj, dhe ia kam treguar.

Mirëpo problemi që e ngriti këshilltarja znj.Adelinë Stublla, është problem shqetësues dhe këtë duhet ta dimë të gjithë, përkatësisht bëhet fjalë për dikë i cili shkon edhe ia drejton armën dikujt duke e detyruar të kryej një detyrë në mënyrë të dhunshme, pra nuk është problem i thjesht sikur të themi shembull, keni vë gypa të kanalizimit por si ke vënë rërën ose se keni mbuluar ashtu si duhet, por në rastin e cekur kemi të bëjmë me jetën e njeriut dhe me kërcënim direkt nën masa të armës në vendin e punës dhe atë midis qytetit. Nuk jam Drejtor sepse këtë punë do ta kryeja këtu pa lëvizur fare, dhe mu këtu do të vinin Policia dhe do të merrnin intervistime, nën masa konfidenciale rreth rastit të cekur që ka të bëjë me kërcënim me armë apo jo, pra kjo më intereson mua, sepse çështja e ngritur është çështje e ndjeshme, dhe nuk mund ta lejojmë ne (edhe pse jam në opozitë) që një mjek në Podujevë të kërcënohet, pra nuk e mbështesë askënd që të shkoj në vend të punës të një punëtori shëndetësorë në këtë rast dhe ta kërcënoj atë me armë zjarri, kush do qoftë ai person, nuk do ta lejoja unë personalisht. Pra të mbetet konfidenciale për qytetarët ai rast dhe ai emër, por jo për Policinë dhe Drejtorinë përkatëse.

z.Vendenis Lahu, theksoi, pajtohem me atë që kolegu z.Hasan Ajeti e potencoj, përkatësisht me cilësimin e tij që fjalimet tona ishin politike, andaj edhe fjalimin e tij i cili i cilësoj fjalimet tona politike po ashtu edhe unë e cilësoj atë si politik, ngase mendoj që ne këtu jemi politikë dhe për çështje politike prandaj edhe fjalimet janë politike dhe nuk shoh asgjë të jashtëzakonshme në këtë aspekt.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, ftoj të pranishmit të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, konkretisht diskutimet të jenë në kuadër dhe në frymë të pikave të rendit të ditës, të mos dilet nga tema dhe të merremi me gjëra tjera.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, në rrethana të tilla ne shpesh herë po kemi të vështirë të replikojm dhe të polemizojmë, por një fakt është që ne kemi vetëm fakte të deponuara në kuptimin që në QKMF Podujevë deri më tani nuk e kemi asnjë kërcënim dhe asnjë element të evidentuar që ndokush nga punëtorët shëndetësorë është kërcënuar me armë. Mjekët dhe punëtorët tjerë shëndetësorë e dinë misionin e tyre dhe profesionin e tyre që e kanë, dhe absolutisht ndonjëherë mund të ndodh që ndonjë qytetarë të shkojë në QKMF, gjithnjë duke pasë barrën e sëmundjes që ka dhe ndoshta nuk mund ta gjejë atë që ka kërkuar dhe që ka menduar se do ta merre aty për aty, mirëpo kërcënim me armë deri në këtë moment, ashtu siç u njoftova tani, nuk ka pasë.

Edhe një gjë dëshiroj të tregoj, në shtëpinë e shëndetit, përveç punëtorëve shëndetësorë janë edhe punëtorë tjerë të cilën kanë pozita të ndryshme, një nga ato janë edhe rojet të cilët kanë për detyrë sigurimin e objekteve, por kurrë njëherë nuk kemi pas sigurim për personelin sepse kemi llogaritur që përgjegjësinë për sigurinë e punëtorëve në QKMF dhe të gjithë resorët publik dhe ata privat e ka

Policia e Kosovës, andaj edhe nuk kemi llogaritur asnjëherë se jemi në kuadër të kësaj strukture të sigurisë.

Sa i përket qenve endacak, unë për nga pozita profesionale që kam, në kuptimin human, mendoj që duhet ta marrim parasysh që qentë endacak janë kafshë shtëpiake të cilët nuk kanë pronar, pra fatkeqësisht nuk kanë pronar, por Qeveria e Republikës së Kosovës bashkërisht me një digaster të veçantë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka bërë një ndihmë ku ata qenë endacak të jenë të vaksinuar dhe tani sa jam i informuar ka mbetë që edhe shumëzimi i tyre të jetë nën kontroll, kurse nëse ndokush mendon që qentë endacak duhet të asgjësohen, mendoj se është gabim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë rreth kësaj pike.

3. Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2020

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, e paraqiti, po ashtu në cilësinë e Koordinatorit të KKSB-së në Komunën e Podujevës e paraqiti Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2020, ndër të tjera theksoi, në këtë situatë parazgjedhore ka rastësisht të kem këto tema mirëpo me mirëkuptim po mundohem ti përfundoj megjithëse janë tema të përgjithësuara dhe nganjëherë mund të rrëshqasin për fushatë.

Megjithatë para vetës keni planin e punës së KKSB-së për vitin 2020 në të cilin është punuar bukur shumë dhe në një formë është i ngjashëm nga vitet paraprake dhe që praktikohet gjithandej Komunave sepse temat dhe fushverpimatria e Këshillit është e tillë. Pavarësisht kësaj i mirëpresim me gjithë dëshirë këshillat, sugjerimet dhe pika apo tema tjera të cilat mund të shtrohen dhe që mund të jenë të arsyeshme.

Kemi konsideruar që ky Plan i përfshinë të gjitha ato problematika duke përfshirë edhe disa prej çështjeve që u cekën nga disa parafolës në pikën paraprake, qoftë për qentë endacak, qoftë për sigurinë shkolla e të tjera. Është standard që në çdo takim të Këshillit ta kemi një informatë nga Komandanti i Stacionit të Policisë i cili ndër të tjera gjithëherë jep statistika të Policisë për tërë territorin e Komunës, gjë të cilën mund ta shihni edhe në informatën paraprake, si dhe gjitha dukuritë tjera të kësaj natyre. KFOR gjithashtu merre pjesë në takime por që sa i përket informacioneve dhe diskutimeve është i shumë i shkurtër, pastaj pjesë e këshillit është edhe një Përfaqësues i FSK-së i cili zakonisht ka fjalën në rastet kur një çështje ka të bëjë me veprimet apo aktivitetet e FSK-së në territorin e Komunës së Podujevës. Zakonisht dy herë në vit kemi informata nga për sigurinë në shkolla dhe çështje tjera që kanë të bëjë me arsimin dhe sigurinë ku Këshilli informohet nga Drejtori i DKA-së dhe Komandanti i Stacionit të Policisë dhe janë të paraparë gjithë bartësit e aktiviteteve siç janë në çdo pikë të paraparë në këtë Plan. Po ashtu kemi paraparë edhe informatë të bazuar në strategjinë Qeveritare 2015-2020 rreth parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu një çështje për të cilën kemi bërë fushatë senzibilizuese është edhe fushata për parandalimin e zjarreve para dhe pas periudhës së korrje shirjeve dhe djegies së pyjeve eventuale e që Komuna jonë për fat të keq përballet me zjarre të shumta ku statistikat janë rreth 700 intervenime në vite nga zjarrfikësit ku mbi 90% e tyre janë për zjarre qoftë fushore qoftë të pyjeve.

Pastaj kemi gjendjen e pyjeve, temë kjo të cilës nuk mund t'i ikim asnjëherë në KKSB ku jepen informata, rekomandime dhe masa konkrete nga ana e Drejtorisë përkatëse dhe akterët tjerë relevant. Kemi edhe tema tjera siç është ajo për dukuritë negative si temë e përgjithshme ku bëjnë pjesë problemet rreth narkotikëve, vjedhjeve dhe të ngjashme që keni mund ti shihni edhe në raportet e Policisë që janë të përfshirë në këtë informatë e që sigurisht që keni vërejtur se disa prej atyre

problemeve janë më të theksuara siç është paqësisht dhuna në familje e cila ka qenë shumë aktuale në Komunën e Podujevës ashtu siç ka qenë në tërë Kosovën, problem për të cilin sigurisht keni dëgjuar se ka pas raste probleme familjare, probleme pronësore, sociale etj, por kontributi për eliminimin e këtyre rasteve ka qenë bukur i madh qoftë nga Drejtoritë përkatëse qoftë nga Policia.

Mandej keni parë se parashihen edhe informata nga zyrtarët kompetent (zyrtari për Integritet dhe Zyra për komunitete dhe kthim) për kthimin dhe riintegrimin e qytetarëve, megjithatë unë i mirëkuptoj këshilltarët e Kuvendit nëse shohin se diçka kemi harruar apo ndonjë çështje nuk është përfshirë të trajtohet në KKSB, por që ky plan nuk është plan ambicioz ku do të futeshin vetëm tema të ndryshme të cilat mund të mos jenë edhe kompetencë e KKSB-së. Pra duke shpresuar që do ta miratoni këtë propozim Plan njëkohësisht pres që të paraqitni edhe tema të cilat vërtetë janë të nevojshme të përfshihen në Plan të punës, ashtu siç keni paraparë në vitin e kaluar dhe që i kemi marrë si të arsyeshme dhe i kemi trajtuar.

z.Bunjamin Hoti, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, lidhur me aktivitetet e parapara në Planin e punës së KKSB-së, ne si Grup i vlerësojmë lartë duke parë që ky dokument i parasheh të gjitha objektivat që ka ky organ mjaft i rëndësishëm i cili funksionon në Komunën e Podujevës dhe për të cilin mund të them se funksionon mjaft mirë dhe këtë e mbështesë edhe në përvojën që kam si pjesë e KKSB-së, aktivitetet e të cilit prekin direkt qytetarin në jetën e përditshme, por dua t'i veçoj aktivitetet që zhvillon KKSB në bashkëpunim me Policinë, ato në shkolla të cilat kanë për qëllim ndaljen apo zvogëlimin e dukurive negative veçmas atyre që e rrezikojnë zhvillimin e mësimin nëpër shkolla tona, po ashtu çështjen e narkotikëve dhe përdorimit të pijeve alkoolike dhe të duhanit nëpër ambiente shkollore, mirëpo edhe vizioni jonë i LDK-së përputhet me aktivitetet që zhvillon ky Këshill është parandalimi i dukurive negative para se të futen uniformat në shkolla. Pastaj forma se si të vetëdijesohen nxënësit nëpër shkolla që dukurit negative të mos jenë prezentë në shkolla, është edukimi jo formal duke mbajtur edhe aktivitete të ndryshme të cilat ndërlidhen me këtë temë. Në Këshill disa herë është diskutuar edhe lidhur me çështjen e sigurisë në shkolla e cila është e ndërlidhur ngushtë me çështjen e sigurisë jashtë shkollave, çështje kjo e cila e preokupon jo vetëm Podujevën por gjithë Kosovën dhe më gjerë. Pra lidhur me sigurinë në shkolla nuk mund të themi se gjenden narkotik në shkolla përderisa ka mundësi të gjenden në hapësira tjera mirëpo falë punës së mirë që bënë Policia e Kosovës shpresojmë që në gjithë Komunën të parandalohet dhe të përfundoj kjo dukuri.

Aktivitete tjera që KKSB ndërmerr në bashkëpunim me akterët tjerë është edhe mbrojtja e pyjeve dhe tokave sidomos në kohën e korrije-shirjeve ku ka raste që digjen hamullit pas korrijeve, gjë për të cilën ka nevojë që ky Këshill të bëjë një fushatë senzibilizuese lidhur me dëmet që shkaktohen tokës bujqësore në raste të djegieve të atyre pjesëve.

Kontribut të veçantë në KKSB dhe në vazhdimësi kanë dhënë gjithherë edhe përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame, të cilët i falënderojë shumë, të cilës bashkërisht punojnë shumë lidhur me parandalimin e Islamit radikal dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe me këtë rast shfrytëzoj rastin t'i uroj për marrjen e detyrës së re z.Mensur Hoti, kryetar i KBI në Podujevë.

z.Pajtim Balaj, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, në bazë të materialeve që unë kam arritur t'i siguroj kam arritur të analizoj këtë Planin vjetor të punës së KKSB i cili për mendimin tim nuk paraqet objektiva të qarta apo masa të veprimit por më tepër paraqitet si një kalendar i raportimit të KKSB-së para Kuvendit. Sipas këtij Plani, KKSB kufizohet në një mekanizëm informimi e që mendoj se do të duhej të ishte më shumë për veprim se sa për informim.

Konsideroj se KKSB duhet bartë funksione të akterëve komunal në adresimin e sfidave të sigurisë publike, përtej kësaj duhet parë si mënyrë e ndërveprimit të këtyre akterëve për arritjen e sigurisë publike. Bazuar në informatën e Këshillit për vitin 2019 është për t'u vlerësuar puna e mekanizmave

të sigurisë, në veçanti i Policisë dhe zjarrfikësve dhe përgjithësisht siguria në Komunën tonë, megjithatë KKSB duhet të kthehet në artikullues të nevojës për intervenime të strukturuar në mbështetje të këtyre institucioneve. Siguria publike nuk duhet lënë barrë e vetëm institucioneve të sigurisë por ajo para së gjithash kërkon veprime të gjithë akterëve tjerë institucional dhe politik e sidomos KKSB. Konsideroj se paraës gjithash duhet merren masa në rritjen e sigurisë në shkollë, trajtimin e qenve endacak, mbështetje dhe kujdes ndaj viktimave të dhunës në familje, me theks të dhunës ndaj grave, pastaj parandalimin e zjarreve qofshin ato të qëllimshme apo nga faktorët tjerë ndikues të cilat mund të bëhet përmes kampanjave mediatike dhe revistuese. Për më tepër secili veprim është investim publik dhe duhet parë në prizmin e sigurisë publike, dhe në këtë kuadër një çështje tjetër e cila edhe mund të duket e parëndësishme është se në shkollat fillore nuk ka parkingje të mjaftueshme për prindërit të cilët i marrin fëmijët e tyre në shkollë, çështje kjo e cila përveç kaosit që shkakton në komunikacion që nga aksidente trafiku apo edhe të nxënësve të ciklit të klasave të ulta. Pastaj duhet bërë investime në objekte publike dhe hapësira të përbashkëta të cilat paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve. Transporti urban është një mundësi e uljes së ngarkesës që i bëhet komunikacionit dhe me këtë edhe ulë mundësinë e aksidenteve sepse do të kishte më pak vetura në trafik dhe aksidente më pak. Për fund pres që së bashku me Planin e punës së KKSB-së ta kemi edhe planin e emergjencave, në veçanti pikave kritike të rrezikut, pra secila masë për sigurinë duhet të paraqitet e shënuar për të marrë fajn e nevojshëm qoftë për politika apo për buxhet.

z.Pajtim Hodolli, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, dua të ngris një çështje e cila ka të bëjë me sigurinë e përgjithshme në Komunën e Podujevës dhe veprimet që janë marrë nga institucionet përkatëse. Duke iu referuar të dhënave të marra nga Policia e Kosovës gjatë vitit 2019 në Komunën e Podujevës janë regjistruar gjithsej 1054 raste dhe sipas kategorizimit të bërë nga Policia del se ka pasur 838 vepra të ndryshme penale, 16 incidente, 4 raste të ngacmimeve seksuale, 200 aksidente komunikacioni prej tyre 13 me lëndime të lehta, por më shqetësuese është fakti që kemi 75 raste ku janë përfshirë të rinjtë e Komunës tonë. Duke iu referuar raporteve të KKSB-së, vazhdimisht është thënë se gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile, çka na bënë të kuptojmë se një Këshill i cili ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të analizojë gjendjen në baza të rregullta dhe të propozojë iniciativë, veprime apo edhe aktivitete të ndryshme, nuk kanë kryer punën e tyre si duhet dhe në pajtim me autorizimet që ka ngase numri i veprave penale, incidenteve, aksidenteve dhe sidomos numri i të rinjve të përfshirë në raste të ndryshme e dëshmon se gjatë vitit 2019 nuk është se ka qenë situatë krejt e qetë dhe stabile.

Nëse analizojmë planin vjetor të punës së KKSB –së shohim se asnjë aktivitet që ka të bëjë me punën në teren nuk është i planifikuar gjatë vitit 2019 e as që pritet të planifikohet në vitin 2020, unë e kam analizuar planin vjetor të punës dhe çdo gjë që shihet është vetëm informata të ndryshme, por jo ndonjë aktivitet që ka ndërmarrë ky Këshill ani pse paguhet nga taksat e qytetarëve për mbledhjet që i mbanë. Po ashtu në raportin që na është dorëzuar si informatë për aktivitetet e KKSB-së, unë do ta quaja procesverbal ngase në të çdo gjë thuhet raportoi ai, raportoi ky, foli ky, ai, por nuk ka diçka e cila do të ishte në interes tonë, ngase këto mund t'i gjejmë edhe në ueb faqe të Komunës. Krejt çka është e planifikuar në planin vjetor të punës së KKSB-së është raportimi nga institucionet e ndryshme që janë pjesë e Këshillit, por, asnjë aktivitet në teren ku do të përfshiheshin të rinjtë, nxënësit apo nënkshillat e KKSB-së ashtu siç e kërkon Rregullorja që përcakton detyrat e KKSB-së. Kjo qasje e Këshillit e bënë ekzistencën e tij vetëm formale, jo funksionale. Për të qenë më i saktë rreth rezultatit të punës së KKSB –së, unë do të doja t'i drejtohem me një pyetje z.Nexhmi Rudarit, por po e shoh që sot nuk qenka këtu prezent, meqë jemi në dijeni se ai është zëvendës kryesues i KKSB-së, por ndoshta ndokush nga zëvendësit e tij mund edhe të përgjigjet. Pyetja është, a janë

themeluar nënëkëshillat e KKSBS-së në nivel Komune dhe a ka ndonjë aktivitet apo projekt që është realizuar në lidhje me fushatën e sigurisë në bashkësi.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh, në cilësinë e Koordinatorit të KKSBS-së, theksoi, fillimisht falënderoj ata të cilët kontribuan që ky plan të jetë më funksional. Rreth diskutimeve nga parafolësit, por ndalem nga këshilltari paraprak z.Pajtim Hodolli, është e drejtë e juaja që të jepni vlerësime dhe ndër të tjera të thoni se KKSBS ka qenë jo funksional, mirëpo vlerësimet për KKSBS i japin institucionet dhe mund të themi se janë ndër vlerësimet më të mira të mundshme, pastaj shumë tema që ceku, nuk kanë të bëjnë me proceset e Këshillit, ndërsa si plan mund ta quani si të doni por në të janë paraparë të gjitha çështjet dhe temat që kanë të bëjnë me sigurinë, prandaj cila është ajo temë e veçantë e cila nuk është brenda këtij plani. Nuk dëshiroj të lëshohem shumë në këto gjëra por mund të them se në dokument mund të shihni shtyllat përkatëse ku janë raportuesit dhe bartësit e aktiviteteve ngase anëtarët e KKSBS-së nuk merren me veprime në terren, por janë anëtarë nga institucione të ndryshme, dhe në këtë aspekt ne personalisht nuk merremi me aktivitete të drejtpërdrejta në terren por ato barten varësisht funksionit dhe fushën përkatëse. Pastaj ajo që u tha se nuk ka vendime, unë ju tregoj vetëm një, dhe atë mund ta shikoni që tani, ku thuhet, KKSBS ka vlerësuar se në Komunën e Podujevës duhet të vendosen kamerat e sigurisë, dhe nga aty është iniciuar një projekt i tillë i cila kam shumë mbi 100,000.00€ dhe që pritet të vazhdoj dhe sërish kemi vlerësuar në mbledhjen e kaluar se është projekt i nevojshëm, i domosdoshëm dhe do t'i kontribuoj sigurisë në përgjithësi, dhe që natyrisht që do të zgjerohet edhe në vende tjera periferike ashtu si do të vlerësoj dhe parashih Policia e Kosovës.

Pra, pa dashur të polemizoj me askënd, është mirë të sqarohen këto gjëra sepse ka një Udhëzim Administrativ dhe akte tjera të cilave ky Këshill i përmbahet sipas kompetencave që ka dhe nuk del prej tyre, e them këtë ngase kamë vërejtur se shpesh ngatërrohet kjo temë duke thënë se KKSBS duhet të merret me disa punë, aktivitete dhe projekte që janë të Drejtorive të ndryshme dhe institucioneve tjera, por jo nuk mund të tejkaloj kompetencat që ka.

Për fund ju falënderoj për kontributin dhe pres që ta miratoni këtë propozim plan dhe të na ndihmoni ta realizojmë, por për dukuri brenda planit dhe dukuri të cilat mund të dalin gjatë vitit, uroj të mos kemi numër të madh të tyre. kam kërkuar që Komandanti i Stacionit të policisë në Podujevë ta ketë brenda vitit një informatë para Kuvendit të Komunës në mënyrë që edhe ju këshilltarët të keni mundësi që drejtpërdrejt të parashtroni pyetje rreth disa dukurive të cilat mund të vlerësohen se janë në ngritje e të cilat natyrisht që në çdo takim të KKSBS-së raportohen si statistika dhe diskutohen.

Meqë unë gjatë diskutimeve nuk vëreja ndonjë propozim të veçantë për tu përfshirë në këtë propozim Plan, edhe njëherë ju falënderoj dhe kërkoj që i njëjti të miratohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj Drejtorin parafolës i cili i japi sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme rreth vërejtjeve, sugjerimeve dhe çështjeve tjera që u ngritën, e që edhe unë personalisht i mirëpres sepse çdo herë janë të mirëseardhura për trajtim dhe analizim të tyre por çdo herë duhet të jenë maksimumin e kompetencave dhe përgjegjësi që ka KKSBS në këtë rast, mirëpo nuk mund të dalim jashtë tyre.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, edhe pse jemi në opozitë natyrisht që replikat i bëjmë me qëllimin e vetëm që të bëjmë diçka sa më të mirë. Ajo që Drejtori parafolës e tha, mendoj se është shumë e lehtë të dim dhe të analizojmë gjendjen se cila janë detyrat dhe përgjegjësitë e KKSBS-së dhe në këtë aspekt ju rekomandoj të merrni dhe të lexoni vetëm raportin e KKSBS-së në Komunën e Vushtrisë dhe do të mund të vëreni se sa aktivitetet merr ai Këshill dhe çfarë pune bënë.

Sërish dëshiroj të parashtroj disa pyetje Drejtorit parafolës pasi veç është duke e zëvendësuar z.Nexhmi Rudarin, dhe atë; 1- a është financuar ndonjë projekt/fushatë vetëdijësuese lidhur me sigurinë në bashkësi që është iniciuar nga ky këshill, 2- a nuk ju duket shqetësuese përfshirja e të

rinjve në disa raste të veprave penale, 3- a nuk ju duken shqetësuese rastet e ngacmimeve seksuale, e që unë paraprakisht i ceka duke u bazuar në raportet e Policisë, dhe 4- Çka duhet të ndodhë në Komunën e Podujevës për të bërë diçka ky Këshill.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ndoshta këto çështje mund t'i diskutojmë në Këshill. Unë kam marrë pjesë në shumë debate dhe takime ku janë hartuar planet komunale të KKSB-ve ngase jam koordinator i KKSB-së dhe kam njohuri sa i përket kësaj çështje, me theks hartimit të planeve. Sa i përket Komunës së Vushtrris që u cek, ajo ndoshta ka një strukturë tjetër të KKSB sa i përket minoriteteve është fjala, dhe natyrisht mund të ketë edhe aktivitete shtesë.

Çështjet që diskutohen rreth aktiviteteve dhe çështjeve tjera në mbledhjet e KKSB-së, janë të hapura dhe mjaft konstruktive nga secili bartës i secilit institucion përgjegjës varësisht çështjes që shtrihet, megjithatë ne mund të kemi edhe tema të ndryshme të cilat mund të trajtohen edhe me Ju anëtarët e Kuvendit e që kanë të bëjnë me sigurinë. Pastaj kemi planin operativ lokal në të cilin ka aktivitete të ndryshme nga disa prej institucioneve lokale siç janë Këshilli i Bashkësisë Islame, Policia e Kosovës, OJQ të ndryshme, e të tjera, për edukimin dhe sensibilizimin e të rinjve kundër dukurive negative, plan i cili hartohet në çdo 2 vjeçar, mandej aktivitete për sensibilizimin e të rinjve për rregullta e trafikut etj etj. Pra do të thotë që ka aktivitete, mirëpo nuk po dëshiroj të lëshohem më shumë për shkak të kohës, por kërkoj nga Kuvendi që ta miratoni këtë propozim plan i cili ngërthen në vete pjesën kryesore dhe çështje tjera që ndërlidhen me sigurinë në bashkësi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë rreth propozim planit të punës së KKSB-së për vitin 2020, andaj meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim plan sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 21 vota për, 3 vota kundër dhe 5 vota të përmbajtura, miratohet Plani i punës së KKSB-së për vitin 2020, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së Kuvendit.

4. Propozimi për zëvendësimin e anëtarit nga radhët e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht e keni parë të gjithë kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, por për transparencë unë do ta lexoj të njëjtën.

Këshilli i Bashkësisë Islame - KBI në Podujevë njofton Komunën e Podujevës për ndryshimin që është bërë lidhur me përfaqësimin e KBI-Podujevë që do ta ketë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe atë nga data 20.02.2020 KBI-Podujevë ka vendosur që ta përfaqësoj z.Mensur Hoti aktualisht kryetar i KBI në Podujevë.

Andaj nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozimi për zëvendësimin e anëtarit nga radhët e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, përkatësisht z.Mensur Hoti, Kryetar i Bashkësisë Islame në Podujevë, zëvendëson z.Osman Kurtollin, ish Kryetar i Bashkësisë Islame në Podujevë dhe anëtar në KKSB – Podujevë.

5. Të Ndryshme

znj.Doruntina Hasani, theksoi, edhe më herët kam shtruar pyetje rreth qenve endacak dhe kemi parë se nuk janë marrë mase rreth këtij problemi.

Pastaj edhe për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit kam pas pyetje edhe më herët, që pse punëtorët e arsimit kur e marrin një pushim të lindjes nuk po zëvendësohen me punëtorë të tjerë e që për pasoj po mbesin nxënësit pa arsimtarë/e, shembull kemi rastin në shkollën e fshatit Metehi ku që 2 muaj nuk ka ndodh zëvendësimi i arsimtares së gjuhës angleze, si dhe rasti tjetër në shkollën e fshatit Kërpimëh, që një muaj, andaj mendoj se është mjaft shqetësuese kjo dhe që është dashtë të ndërmerren masa sepse nuk është hera e par që e kam parashtruar këtë vërejtje.

z.Blerim Maqastena, theksoi, në mbledhjen e kaluar kamë bërë pyetje për mos prezencën e Kryetarit por nuk kam marrë përgjigje, kështu që nuk po dëshiroj më të marrë përgjigje sepse është përgjigjur ish Kryetari.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0016322/20
Podujevë,
02 mars 2020

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi